



MITROVICA

KOMPANIA UJESJELLËSI RAJONAL SH.A.
REGIONAL WATER COMPANY J.S.C.
KOMPANIJA REGIONALNI VODOVOD D.D.

Rruga e Liqenit p.n. – 40000 Mitrovicë

Data: 22.01.24 Nr: 7813

Procedurat për pilotimin e arketimit të llogarive të arkëtueshme përmes PDA në zonat rurale të thella të shërbimit të zonat rurale të thella të shërbimit KRU “Mitrovica” Sh.A.

KRUM - Kompania Rajonale e Ujësjetësimit "Mitrovica" Sh.A
PDA- Personal Digital Assistant

Përmbajtja:

1. QËLLIMI.....	3
2. FUSHEVEPRIMI.....	3
3. ZBATUESHMERIA	8
4. MONITORIMI I ARKETIMIT ME PDA.....	8
5. BARAZIMI	9
6. SIGURIA E TRANSAKSIONIT.....	Error! Bookmark not defined.
7. MANUALI I PERDORIMIT TE PDA-së për inkasim	10

1. QËLLIMI

Ky dokument përcakton politikat dhe procedurat e **KRU "MITROVICA" SH.A.** në lidhje me arkëtimin e faturave dhe borxheve të prapambetura të konsumatorëve.


Qëllimi i zbatimit të këtij udhëzimi është arkëtimi mobil fillimisht në zonat e thella rurale duke ju lehtësuar kështu konsumatorëve që banojnë në këto zona pagesën e faturave për shërbimet e ujësjllesit.

2. FUSHEVEPRIMI

Arkëtimi mobil do të lejohet fillimisht vetëm në zonat rurale të cilat janë të përfshira në këtë udhëzim dhe çdo zone tjetër e cila nuk është e përfshirë nuk lejohet arkëtimi përmes PDA-së, por konsumatori do vazhdoj të bëjë pagesën në pikat e inkasimit të **KRU "MITROVICA" SH.A.**, apo përmes institucioneve bankare dhe jo bankare me të cilat KRUM ka marrveshje dhe janë tëë postuara në web faqen e KRUM.

Sipas Njesive Operative, zonat rurale të cilat të lejohet inkasimi me PDA janë këto:


- **Nj.Op. Mitrovicë** : Stan Tërg , Rahovë



ZONAT RURALE QË LEJOHET INKASIMI ME PDA MITROVICË




LEGJENDA

 Kufi - zonë rurale

1: 27000 cm

- **Ni.Op. Vushtrri** : Stanovc i Epërm dhe Stanovc i Ulët, Lum i Madh, Maxhunaj, Druar, Mihaliq ,Vernicë, Reznik, Kollë, Dubovc ,Galic, Bruznik dhe Bukosh


ZONAT RURALE QË LEJOHET INKASIMI ME PDA



h

- **Nj.Op. Skenderaj**: Vojnik, Ozrdim, Jashanicë, Kopiliq i Ulët, Aqarevë, Kolldernicë, Kopiliq dhe Rakinicë .

ZONAT RURALE QË LEJOHET INKASIMI ME PDA



Nëse paraqitet nevoja për zgjerim të këtyre zonave, kjo do të lejohet vetëm më kërkesë të Menaxherave të Njesisë Operative dhe aporvimit nga menaxhmenti dhe bordi drejtues.

Afati Kohor

Ky process do të filloj të aplikohet nga Muaji Mars 2024 deri në Qershor 2024. Nëse ky process rezulton me performance të mire atëher do të parashtrahet një kërkesë nga ana e Drejtorit për Shërbim të konsumatorëve pranë Bordit të Drejtorit , në mënyrë që të rishikohen të arriturat dhe mundësia e vazhimit të këtij procesi.

k

3. ZBATUESHMERIA

Politikat dhe Procedurat e Arkëtimit të Borxheve është dokument zyrtar dhe i zbatueshëm i Kompanisë. Si i tillë ky dokument është i zbatueshëm nga i gjithë personeli i Kompanisë që është i përfshirë në procesin e faturimit dhe arkëtimit të faturave për shërbimet e ofruara nga Kompania.

Mosrespektimi i këtyre politikave dhe procedurave paraqet shkelje të rëndë të rregullave të punës dhe rrjedhimisht sanksionohet me masa ndëshkimore konform procedurës disiplinore.

Për interpretimin e këtyre politikave dhe procedurave, si dhe për zgjidhjen e keqkuptimeve eventuale apo rasteve të veçanta duhet të kontaktohet:

- a. Menaxheri i Shërbimeve të Konsumatorëve, dhe
- b. Zyrtari i Lartë Financiar i Kompanisë.

Procedura e arkëtimit me PDA do të kryhet nga lexuesit e PDA-ve të secilës zone përkatëse dhe qasje për arkëtim do t'i lejohet vetëm në zonat rurale që janë të cekura në këtë dokument. Çdo arkëtim nga ana e lexuesit që nuk përfshin këto zona do të ndëshkohet....?????

4. MONITORIMI I ARKETIMIT ME PDA

Arkëtimi përmes PDA-së do të monitorohet nga Departamenti I Financave dhe Departamentit Komerical.

Fatura duhet të jetë në format të printuar dhe ti dorëzohet Konsumatorit personalisht në adresën e tij jo më vonë se 15 ditë para afatit të pagesës. Konsumatorët e këtyre zonave gjithashtu kanë të drejtën e pagesës së faturave në formë të rregullta (në pikat e inkasimit).

Ndërsa pas arkëtimit të Faturës ose borxheve, lexuesi është i obliguar t'i dorzojë deshmënë e pagesës konsumatorit me këto informata:


- të dhënat e konsumatorit,
- shumën e paguar,
- datën e pagesës,
- saldon e mbetur (borxhi i mbetur),
- dhe vula elektronike "E Paguar".

Konsumatorët janë të detyruar të paguajnë faturën për shërbimet e ujit të pijshëm dhe kanalizimit. Fatura e ujit është dokument valid në bazë të cilit mund të realizohet procedura e përmbarimit të borxhit.

Vet fakti i pranimit të Faturës do të konsiderohet si lidhje e Kontratës së Shërbimit.

5. BARAZIMI

- Lexuesit janë të obliguar që mjetet financiare të inkasuara në fund të orarit të punës t'i deponojnë në Bankë ose në Institucionet Mikrofinanciare në llogaritë e **KRU "MITROVICA" SH.A.**
- Lexuesit janë të obliguar që çdo ditë pune në mengjes të bëhet barazimi i dëftesave të pagesës më dëshminë e deponimit në Bankë me Shefat e Faturimit / Arkëtimit të Nj. Operative
- Shefat e Faturimit / Arkëtimit janë të detyruar të kryejn barazimin arkëtimit me PDA kundrejtë shumës së deponuar.
- Shefat e Faturimit /Arkëtimit duhet të azhurojnë këto pagesa në llogaritë e konsumatorëve dhe të ruajnë këto dëftesat e pagesës.



7. MANUALI I PERDORIMIT TE PDA-së për inkasim

Sistemi i pagesave përmes pajisjeve për faturim Mobil

Për lejimin e pagesave nga sistemi i faturimit mobil offline, së pari sigurohemi që përmes aplikacionit për monitorim, lexuesit në fjalë a iu është lejuar pjesa e arkës siq shifet më poshtë.

Emri i përdoruesit
[Redacted]

Gjinia
Mashkull

Komuna
Vushtrri

Lejo i arkën
Jo

Save Anulo

Pra, tek përdoruesi, në pjesën Lejo Arkën, zgjedhim opsionin "PO" duke caktuar edhe "Prefiksi i kodit të pagesës" i cili prefiks lidhet me kodin e Lexuesit dhe e ruajm në "Save"

Emri i përdoruesit
[Redacted]

Gjinia
Mashkull

Komuna
Vushtrri


Lejo i arkën
Po

Prefiksi i kodit të pagesës
[Redacted]


Save Anulo

KA

Pasi që është rregulluar pjesa në sistemin monitorues, atëherë në pajisjen e lexuesit pas sinkronizimit të të dhënave do iu shfaqet edhe një mundësi shtesë në pajisjen e tij e cila mundëson futjen e pagesave (pagesa vetëm për konsumatorët e tij të cilat janë të lidhura me sistemin e faturimit)




Duke zgjedhur menyën për pagesa, hapet dritarja me opsionet si më lart, ku nga këto opsione zgjedhim "Hap ndërrimin"




ba

Pasi që kemi hapur ndërrimin për pagesa, fillojmë me "Regjistrimi i pagesave" ku më pas hapet lista e konsumatorëve nga të cilët zgjedhim konsumatorët të cilët dëshirojnë të bjnë pagesa.




Regjistrimi i pagesave




Lista ku bëhet zgjedhja e konsumatorëve për pagesë

Pasi që kemi bërë zgjedhjen e konsumatorit, shfaqet dritarja për pagesë, ku vendosim shumën për pagesë dhe bëjmë printimin e dëshmisë (Dëftesës) së pagesës së bërë.




Vendosim shumën për pagesë

Butoni për printim të dëftesës




Dëftesa e printuar

Tek "Lista e pagesave aktuale" hapet raporti me pagesat e bëra gjatë këtij ndërrimi, ku kemi mundësinë edhe të anulimit të ndonjë pagese të bëra gabimisht.




Lista e pagesave të bëra gjatë këtij ndërrimi




Anulimi i pagesave të bëra gabimisht

Handwritten signature

Nga menyja e pagesave, pasi që kemi përfunduar punën, zgjedhim opsionin "Mbyll ndërrimin" ku me këtë rast mbyllim pagesat e bëra për atë ditë.



Mbyllja e ndërrimit



Informimi që tregon se ndërrimi është mbyllur me sukses

Pas kësaj, ky ndrrim është postuar dhe këto të dhëna kanë mbëri në sistemin e faturimit (Billing) dhe nga "Lista e ndërrimeve" bëhet printimi i raportit për atë ditë.

← Lista e ndërrimeve

1

Data e hapjes: 10/01/2024
Data e mbylljes: 10/01/2024

Gjithësej pagesa: 0
Shuma e pagesave: 0.0

Gjithësej pag. anuluar: 1
Shuma e pag. anuluar: 1.0

Statusi:
Postuar

Printo raportin

Informimi i cili tregon detajet e ndërrimit

Raporti i ndërrimit

Arkatar (Inkasanti)

Totali i pagesave: 0
Shuma e pagesave: 0.00

Tot. pag. anuluar: 1
Shuma pag. anuluar: 10.00

Data e hapjes: 10.01.2024 10:08
Data e mbylljes: 10.01.2024 10:09

Raporti i ndërrimit i printuar

Kumrije Kelmendi Aliu

Kryesuese e Bordit të Drejtoreve



